



Data: **14.09.2015**

Për: **“Bean” sh.p.k, Lagje Qëndër, pranë shkollës 8 – vjeçare, Levan, Fier**

Procedura e prokurimit: **Tender i hapur**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i rrugës Kamçisht – Ngurrëz e Vogël”.**

Publikime të mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike, 06.07.2015**

Njoftojmë se kanë qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesit me vlera përkatëse të ofruara:

1. “Bean” sh.p.k, me vlerë të përgjithshme 22,918,542 Lekë (pa TVSH).
2. “Be Is” sh.p.k, me vlerë të përgjithshme 25,456,850 Lekë (pa TVSH).
3. “Sireta 2F” sh.p.k, me vlerë të përgjithshme 28,888,888 Lekë (pa TVSH).
4. “Leon” sh.p.k, me vlerë të përgjithshme 29,042,948 Lekë (pa TVSH).
5. “Glavenica” sh.p.k, nuk ka paraqitur ofertë.

6. “Ndregjoni” sh.p.k, me vlerë të përgjithshme 24,661,275 Lekë (pa TVSH)
7. BO “Theos” sh.p.k. & “Al Asphalt” sh.p.k, me vlerë të përgjithshme 25,933,659 Lekë (pa TVSH).
8. “GPG Kompani” sh.p.k, me vlerë të përgjithshme 20,020,553 Lekë (pa TVSH).
9. BO “Xhast” sh.p.k. & “Denis 05” sh.p.k, me vlerë të përgjithshme 26,461,900 Lekë (pa TVSH).
10. “Alba Konstruksion” sh.p.k, me vlerë të përgjithshme 23,292,504 Lekë (pa TVSH).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

“G.P.G. Kompani” sh.p.k, për arsye se:

Shoqëria “G.P.G Kompani” sh.p.k, nuk plotëson kërkesën për disponimin e kamionëve. Nga kamionët e paraqitur vetëm kamionët me targa LU9215B, LU1167C, AA486BJ, AA691GS, AA510EB, LU0783C dhe LU0572C disponohen nga shoqëria “G.P.G. Kompani” sh.p.k, ndërsa kamionët e tjerë i janë dhënë me qera shoqërisë “Albgarden” sh.p.k, me kontratën nr. 2296 Rep, nr. 1175 Kol, datë 11.06.2014, lidhur para noterit Fran Gjoni në Lezhë. Konkretisht shoqëria “G.P.G. Kompani” sh.p.k, disponon vetëm shtatë kamionë nga tetë të kërkuar në kërkesat për kualifikim, duke mos e plotësuar këtë kriter.

Kapacitetet teknike të kësaj shoqërie janë të deklaruara e të angazhuara edhe në kontratën me objekt: “Sistemim asfaltim i rruges Toshkëz – Zhelizhan – Mazhaj”, me vlerë 48.418.990 Lekë pa TVSH, lidhur me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në datën 03.06.2015, me afat përfundimi 90 ditë.

“Alba Konstruksion” sh.p.k, për arsye se:

Nuk plotëson kërkesën për pagesën e taksave lokale. Kjo shoqëri nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e taksave vendore në Shkrel – Shkodër dhe Lushnje, ku ajo zhvillon aktivitet sipas ekstraktit të QKR.

Nuk plotëson kërkesën 2.4.7 për kualifikim pasi ka paraqitur deklarate disponibiliteti vetëm për ing. Genc Xhafa dhe jo për inxhinierët e tjerë.

“Ndregjoni” sh.p.k, për arsye se:

Nuk plotëson kërkesën 2.4.3 për kualifikim lidhur me stafin e kërkuar, pasi mungon diploma ing. mekanik Hysen Markeci dhe diploma e ing gjeodet Shaban Leti.

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Theos” sh.p.k. (40%) dhe “Al Asphalt” sh.p.k. (60%) për arsye se:

Shoqëria “Theos” sh.p.k, nuk plotëson kërkesën për pagesën e taksave lokale. Kjo shoqëri nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e taksave vendore në Elbasan, ku ajo zhvillon aktivitet sipas ekstraktit të QKR.

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Xhast” sh.p.k. (60%) dhe “Denisi 05” sh.p.k. (40%) për arsye se:

Shoqëria “Xhast” sh.p.k, nuk plotëson kërkesën për pagesën e taksave lokale. Kjo shoqëri nuk ka paraqitur vërtetim për pagimin e taksave vendore në Golaj – Kukës, ku ajo zhvillon aktivitet sipas ekstraktit të QKR.

“Glavenica” sh.p.k, për arsye se nuk ka paraqitur ofertë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“Bean” sh.p.k, Lagje Qëndër, pranë shkollës 8 – vjeçare, Levan, Fier, se me ofertën e paraqitur në shumën 22,918,542 Lekë (pa TVSH), është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2007 “Për prokurimin publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë: Në datë 27.08.2015

Ankesa:

1. Ankesë nga ana e operatorit ekonomik “GPG Kompnai” sh.p.k, me datë 31.08.2015 dhe ka marrë përgjigje nga Autoriteti Kontraktor me datë 03.08.2015.

